



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1644 / 2 Prot.

Vlorë më, 28.10. 2021

VENDIM
Nr. 39, datë 28.10.2021

PËR
NJË NDRYSHIM NË KRITERIN E GJUHËS SË HUAJ PËR PRANIMET NË
CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

Në mbështetje të nenit 38, nenit 76, pika 4 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë fundin e vitit të parë akademik të studimeve si afatin për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj, për studentët e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2021-2022.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtuesit e njëjësive kryesore, Drejtuesit e njëjësive bazë, Kryesekretaritë si dhe sekretaritë mësimore në fakultet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ

